

Përmbajtja

Parathënie	v
Universi, Perënditë dhe njeriu	11
Zanafilla e gjithësisë	13
Lufta e perëndive dhe mbretëria e Zeusit.....	23
Bota e qenieve njerëzore	53
Lufta e Trojës	71
Odiseu ose aventura njerëzore	91
Dionisi në Tebë	135
Edipi jo kur duhet	151
Perseu, vdekja, shëmbëlltyra	169

Parathënie

*N*a ishte njëherë... ky qe titulli që mendova fillimisht t'i vija këtij libri. Më në fund, vendosa ta

zëvendësoja me një titull tjetër, më domethënës. Mirëpo, në nisje të veprës nuk mund të mos përmend kujtimin të cilit i bënte jehonë titulli i parë dhe që i dha shkas këtyre faqeve.

Një çerek shekulli më parë, kur im nip ishte ende fëmijë dhe i kalonte pushimet me mua e time shoqe, kishim vënë një rregull që për ne ishte po aq rutinë sa dhe të larët e të ngrënët: çdo mbrëmje, me të ardhur ora që Zhylieni shkonte në shtrat, e dëgjoja tek më thërriste që nga dhoma e vet, shpeshherë me një lloj padurimi: “Zhipe¹*, dua përrallën, përrallën!” Unë shkoja i ulesha pranë dhe i tregoja ndonjë legjendë greke. S’e kisha të vështirë të qëmtoja në morinë e miteve me të cilët merresha gjithë kohën duke i analizuar, zbërthyer, krahasuar, interpretuar, duke u rrekur që t’i kuptoja, por që atij ia përcillja tjetërsoj, lirshëm, ashtu siç më vinin në mendje, si të ishin përralla me zana, pa e vrarë trurin për gjë tjetër gjatë të rrëfyerit, nga kreu në fund, përveçse të mos humbisja fillin e tregimit dhe të ruaja tensionin dramatik: na ishte një herë... Me veshët pipëz, Zhylieni dukej i lumturuar. Ashtu si dhe unë. Gëzohesha që po i përcillja me zërin tim pakëz nga ajo botë greke, pas së cilës jam aq i dhënë dhe mbijetesa e së cilës te secili prej nesh, në botën e sotme, më duket e nevojshme më shumë se kurrë. Më pëlqente po ashtu, që këtë trashëgimi ta merrte gojarisht, sipas asaj mënyre që Platoni e quan rrëfenjat e mëndeshës, ashtu si gjërat që përcillen nga brezi në brez, pa pasur lidhje me ndonjë arsim zyrtar, pa ndihmën e librave, duke formuar kështu repertorin e pashkruar të dijeve dhe praktikave: duke nisur që me rregullat e hijeshisë kur flasim e veprojmë, te sjellja e duhur, te teknikat fizike, si mënyra e të ecurit, vrapimit, notimit, ngarjes së biçikletës, ngjitjes në male...

Sigurisht, ishte naive të besoj se unë po ndihmoja për të mbajtur gjallë një traditë legjendash të moçme, duke ia rrëfyer çdo darkë me zërin tim një fëmije. Por, qe një kohë, me ç’më kujtohet - e kam fjalën për vitet shtatëdhjetë -, kur mitit po i shkonte puna fjollë. Pas Dumezil-it dhe Levi-Strauss-it, ethet e studimeve mitologjike kishin mbërthyer një radhë helenistësh që, bashkë me mua, i ishin përveshur punës për të hulumtuar botën legjendare të Greqisë së Lashtë. Sa më shumë që bënim përpara me analizat tona, aq më problematike bëhej ekzistenca e një mendimi mitik në përgjithësi, duke na bërë të pyesnim veten: çfarë është një mit? Ose më saktësisht, duke mbajtur parasysh fushën tonë të kërkimit: çfarë është miti grek? Sigurisht, është një rrëfenjë. Duhet ditur, ama, edhe se si u mbujtën këto rrëfenja, si u ngulitën, si u përcollën, si u ruajtën. Mirëpo, në rastin e mitologjisë greke, ato na kanë mbërritur vetëm aty nga fundi, në trajtë tekstesh të shkruara, më të hershmit e të cilëve u përkasin veprave letrare të të gjitha gjinive, epepe, poezi, tragjedi, histori, madje edhe

¹ Zhipe: shqiptimi ledhatar i shkronjave të para të emrit Zhan – Pier.

filozofi. Dhe, me përjashtim të *Iliadës*, të *Odisesë* dhe të *Teogonisë* së Hesiodit, më së shpeshti, paraqiten të shpërndara, në gjendje fragmentare, nganjëherë vetëm duke aluduar për to. Pikërisht në një periudhë të vonë, vetëm aty nga fillimi i erës sonë, dijetarët i mblodhën këto tradita të shumëllojshme, pak a shumë të ndryshme, për t'i paraqitur të bashkuara në një korpus të vetëm, radhitur njëra pas tjetrës, si në raftet e një *Biblioteke* (po të përdorim titullin që Apollodori i dha përmbledhjes së vet, që u bë një nga veprat e mëdha klasike në këtë fushë). Kështu u ndërtua ajo që është bërë zakon të quhet mitologjia greke.

Mit, mitologji, në të vërtetë, janë fjalë greke që lidhen me historinë dhe me disa tipare të këtij qytetërimi. A mos duhet të arrijmë në përfundimin se jashtë tij nuk është me vend të përdoren e se miti dhe mitologjia ekzistojnë vetëm në trajtën e në kuptimin që u kanë dhënë grekët? Krejt e kundërta. Që të mund të kuptohen, vetë legjendat helene duhen krahasuar me rrëfenja tradicionale të popujve të tjerë, që u përkasin kulturave dhe epokave shumë të ndryshme, qoftë edhe kur është fjala për kulturën e lashtë të Kinës, të Indisë, të Lindjes së Afërme, të Amerikës parakolombiane a të Afrikës. Krahasimi është bërë i detyrueshëm, ngaqë këto tradita rrëfimore, sado të ndryshme qofshin, shpërfaqin midis tyre dhe në krahasim me rastin grek, mjaft pika të përbashkëta për t'i përfruar me njëra-tjetrën. Le të pohojë Claude Levi-Strauss-i si një konstatim se një mit, ngado që të vijë, duket sheshit përnjëherësh se është i tillë, pa rrezikuar ta ngatërrojme me forma të tjera rrëfimi. Në të vërtetë, ai dallohet qartë nga rrëfimi historik që, në Greqi, lindi në njëfarë mënyre *kundër* mitit, sepse u paraqit si kumtimi i saktë i ngjarjeve të ndodhura aq vonë, sa të kishin dëshmitarë të besueshëm. Sa për rrëfimin letrar, ai është thjesht një trillim që paraqitet haptazi si i këtitillë, vlera e të cilit varet, para së gjithash, nga talenti dhe mjeshtëria e atij që e shtjellon. Normalisht, këto dy tipa rrëfimi i atribuohen një autori që merr përgjegjësinë për ta dhe që ia përcjell me emrin e vet, në trajtën e një veprë të shkruar, një publiku lexuesish.

Krejt tjetër është statusi i mitit. Ai paraqitet si rrëfenjë që ka ardhur nga thellësia e kohërave dhe që ekzistonte para se ndonjë tregimtar të niste ta rrëfente. Në këtë kuptim, rrëfimi mitik nuk ka të bëjë me trillimin vetjak, as me fantazinë krijuese, por me përcjelljen gojë më gojë dhe me kujtesën. Kjo lidhje intime e funksionale me ngulitjen në kujtesë e përfron mitin me poezinë që, në zanafillë, në shfaqjet e saj më të hershme, mund të ngatërrohet me procesin e përpunimit mitik. Në këtë pikëpamje, tipik është rasti i epopesë homerike. Për të thurur rrëfenjat e saj mbi bëmat e heronjve legjendarë, epopeja veprroi së pari sipas mënyrës së poezisë gojore që hartohet e këndohej përpara dëgjuesve nga breza të njëpasnjëshëm aedësh të frymëzuar nga hyjnesha Kujtesë (Mnemozina) dhe vetëm më vonë ajo u bë objekt i një redaktimi që merrte përsipër të hartonte e të nguliste tekstin zyrtar.

Edhe sot e kësaj dite, një poemë gjallon vetëm kur thuhet me zë. Ajo duhet ditur përmendësh dhe, për t'i dhënë jetë, duhet recituar me fjalët e heshtura të ligjërit të brendshëm. Edhe miti është i gjallë vetëm nëse vazhdon të rrëfëhet brez pas brezi, në jetën e përditshme. Përndryshe, i degdisur në fund të bibliotekave, i ngrirë në trajtë shkrimesh, ai kthehet kështu në referim diturak për një elitë lexuesish të specializuar në fushën e mitologjisë.

Kujtesë, gojëtar, traditë: pikërisht këto janë kushtet për ekzistencën dhe mbijetesën e mitit. Ato i diktojnë atij disa tipare karakteristike, që shfaqen më qartas po të ndjekim qasjen midis veprimtarisë poetike dhe veprimtarisë mitike. Roli që i ngarkojnë fjalës secili nga këto kushte, nxjerr në pah një

dallim thelbësor midis tyre. Qëkurse në Perëndim, në kohën e trubadurëve, poezia u bë autonome - qëkurse ajo u nda jo vetëm nga rrëfimet e mëdha mitike, por edhe nga muzika që e shoqëronte gjer në shekullin XIV - ajo u ngjiz si një fushë specifike e shprehjes gjuhësore. Qysh asohere, çdo poemë përbën një ngrehinë të veçantë, shumë komplekse, sigurisht polisemike, por të organizuar më së miri, aq shumë të lidhur në pjesët e saj të ndryshme e në të gjitha nivelet e saj, saqë duhet të mbahet mend dhe të recitohet ashtu siç është, pa i hequr gjë, dhe pa e ndryshuar. Poema mbetet identike përmes të gjitha interpretimeve që e aktualizojnë në hapësirë e në kohë. Fjala që i jep jetë tekstit poetik në publik, për dëgjuesit apo privatisht për vetveten, ka një figurë unike e të pandryshueshme. Po u ndryshua një fjalë, po u la një varg, po u zhvendos një ritëm, e gjithë ngrehina e poemës shembet përdhe.

Përkundrazi, rrëfimi mitik nuk është ashtu si teksti poetik, vetëm polisemik në vetvete me rrafshet e shumëfishta të domethënies. Ai nuk është i ngulitur në një trajtë përfundimtare. Përmban gjithmonë variante, versione të shumëfishta që rrëfimtari i gjen gati, i zgjedh në funksion të rrethanave, të publikut a të parapëlqimeve të veta e ku ai mund të heqë, të shtojë, të ndryshojë, nëse e sheh të udhës. Për aq kohë sa mbahet gjallë e ka lidhje me mënyrat e të menduarit dhe me zakonet e një grupi, një traditë gojore legjendash nuk ngurtësohet: rrëfimi mbetet pjesërisht i hapur për përtëritje. Kur mitologu antikuar e gjen në fund të shndërrimeve, tashmë të fosilizuar në shkrime letrare a shkencore, siç e kam thënë për rastin grek, çdo legjendë, për t'u zbërthyer ashtu si duhet, i kërkon që ta zgjerojë hetimin shkallë-shkallë: nga një version i veti të të gjithë të tjerët, sado më të rrëgjuar qofshin, me të njëjtën temë, pastaj të rrëfenja të tjera mitike të afërta a të largëta, madje të tekste të tjera, që i përkasin sektorëve të ndryshëm të po asaj kulture: letrarë, shkencorë, politikë, filozofikë, fundi i fundit të rrëfime pak a shumë të ngjashme të qytetërimeve të largëta. Në të vërtetë, ajo çka i intereson historianit dhe antropologut, është pikërisht plani i dytë intelektual, për të cilin dëshmon filli i rrëfimit, korniza ku është thurur, çka mund të zbulohet vetëm përmes krahasimit të rrëfenjave, përmes shqyrtimit të dallimeve dhe ngjashmërive të tyre. Për mitologjitë e ndryshme janë me vend vërejtjet që bën me shumë të drejtë Jacques Roubaud për poemat homerike me elementin e tyre legjendar: “Ato nuk janë thjesht rrëfenja. Ato përmbajnë visarin e ideve, të trajtave gjuhësore, të përfytyrimeve kozmologjike, të rregullave morale, etj., që përbëjnë trashëgiminë e përbashkët të grekëve të epokës paraklasike”.

Në punën e vet rrëmuese për të nxjerrë në dritë këto “visare” të pazbuluara, këtë trashëgimi të përbashkët të grekëve, hulumtuesi mund të provojë herë-herë një ndjenjë zhgënjimi, sikur gjatë kërkimit të vet t'i kishte humbur nga sytë “kënaqësia e madhe” që La Fonteni parashikonte se do të provonte çdokush që do dëgjonte rrëfimin “Lëkura e gomarit”. Këtë kënaqësi të rrëfimit që përmenda në fillim të kësaj parathënieje, do ta kisha qarë, e pa shumë keqardhje, nëse një çerekshekulli më pas, në po atë ishull të bukur ku shijoj bashkë me Zhylienin pushime e rrëfenja, disa miq të mos më kishin kërkuar një ditë t'u rrëfeja ca mite greke. Gjë që e bëra. Atëherë, ata më nxitën, me shumë këmbëngulje, që ta hidhja në letër atë çka u kisha rrëfyer me gojë. Nuk qe e lehtë. Kalimi nga fjala të tekstit i shkruar është mjaft i mundimshëm. Jo vetëm sepse në shkrim humbet ajo çka e mbush me mish e gjak rrëfimin gojor: zëri, tonaliteti, ritmi, gjesti, por edhe ngaqë pas këtyre trajtave të shprehjes gjenden dy stile të ndryshme mendimi. Kur një kumtesë gojore riprodhohet në letër pa asnjë ndryshim, teksti nuk qëndron. Në të kundërt, kur e hartojmë së pari tekstin me shkrim, leximi i

tij me zë të lartë nuk gënjen askënd: ai nuk është sajuar për t'u dëgjuar nga ndokush, është jashtë fushës gojore. Kësaj vështirësie të parë, të shkruash siç flet, i shtohen shumë të tjera. Së pari, duhet të zgjedhësh një version, domethënë, t'i lësh mënjanë variantet, t'i fshish, t'i bësh të heshtin. Dhe te vetë mënyra e rrëfimit të versionit të mbajtur mend, rrëfimtari ndërhyt nga ana e vet e bëhet interpretues në po atë masë që, nga skenari mitik që ai shpalon, nuk ekziston ndonjë model i ngulitur njëherë e mirë. Për më tepër, si i bëhet që hulumtuesi, kur bëhet rrëfyes, të harrojë që është edhe një dijetar në kërkim të themelisë intelektuale të miteve dhe që duhet të fusë në rrëfenjën e vet vetëm ato domethënie që i ka peshuar mirë gjatë studimeve të mëparshme?

Unë i kisha parasysh edhe këto pengesa, edhe këto rreziqe. Megjithatë e hodha hapin. U përpoqa të tregoja si të ishte ende gjallë tradita e këtyre miteve. Kisha dëshirë të dëgjohej përsëri nga lexuesit e sotëm zëri që dikur, ndër shekuj, u drejtohej drejtpërsëdrejti dëgjuesve grekë, por që kishte heshtur. Nëse ia kam dalë dot mbanë në disa faqe të këtij libri, le të jetë po ai zë, si jehonë, që të vazhdojë të kumbojë.

UNIVERSI, PERËNDITË DHE NJERIU

Zanafilla e gjithësisë

Çfarë kishte kur ende nuk ekzistonte diçka, kur nuk kishte asgjë? Kësaj pyetjeje, grekët i janë përgjigjur me rrëfenja dhe mite.

Në fillim fare, ajo çka ekzistoi së pari, qe një Zbrazëtirë. Grekët i thonë *Kaos*. Çfarë është Zbrazëtira? Është një boshllëk, një zbrazëti e errët ku nuk dallohet dot asgjë. Hapësirë përmbysjeje, marramendjeje dhe rrëmuje, pa cak, pa fund. Gjithçka ishte gllabëruar nga kjo Golle, si nga një gojë e stërmadhe që përpin çdo gjë në një natë të vagëlluar. Pra, në pikënisje, është vetëm kjo Golle, humnerë e verbër, e zezë, e pafund.

Mandej u shfaq Toka. Grekët i thonë *Gjea (Gaia)*. Toka ia behu mu në zemër të Gollës. Ja pra, ajo lindi pas Kaosit dhe përbënte, në disa drejtime, të kundërtën e tij. Toka nuk është më ajo hapësirë e errët rënieje, e paskajë, e papërkufizuar. Toka ka një formë të dallueshme, të ndarë, të saktë. Rrëmujs, vagëllimës së errët të Kaosit, i kundërvihen qartësia, fortësia, qëndrueshmëria e Gjeas. Në Tokë çdo gjë është e vizatuar, e dukshme, e qëndrueshme. Gjea mund të përkufizohet si diçka ku hyjnitë, njerëzit e kafshët mund të ecin me besim. Ajo është dyshemeja e botës.

NË THELLËSI TË TOKËS: GOLLJA

Lindur nga Gollja e stërmadhe, bota e ka tanimë një dysheme. Nga njëra anë, kjo dysheme ngrihet lart në formë malesh, nga ana tjetër zhytet thellë teposhtë në formën e një guve të nëndheshme. Kjo guvë e nëndheshme zgjatet pambarimisht, në atë farë mënyre sa, poshtë truallit të fortë e të ngurtë, në themel të Gjeas, gjendet gjithmonë honi, Kaosi. Toka që behu në lukth të Gollës, plekset me të në thellësitë e saj. Ky Kaos u sjell ndër mend grekëve një lloj mjegulle të padepërtueshme ku treten të gjithë kufijtë. Në thellësinë më të madhe të Tokës gjendet ajo pamje kaotike e zanafillës.

Ndonëse Toka duket shumë qartë, ndonëse ajo ka formë të ravijëzuar, ndonëse gjithçka që lind prej saj, ashtu si ajo, do të kenë caqe dhe kufij të qartë, ajo mbetet megjithatë, në thellësitë e veta, e ngjashme me Gollen. Ajo është Dheu i Zi. Mbiemrat që e cilësojnë nëpër rrëfenja mund të jenë të ngjashëm me ata që cilësojnë Gollen. Dheu i Zi shtrihet midis së poshtmes dhe së sipërmes, midis errësirës, rrënjëzimit në Golle, që përfaqësojnë thellësitë e saj, në njërën anë, dhe maleve kreshtëbardhë që lartohet kah qielli, maleve të ndritshme, që me majat më të larta prekin atë zonë të qiellit që përherë lahet në dritë, në anën tjetër.

Në këtë banesë që e ka emrin kozmos, Toka përbën bazën, por ajo nuk ka vetëm këtë funksion. Ajo pjell dhe ushqen çdo gjë, me përjashtim të disa qenieve për të cilat do të flasim më vonë e që kanë dalë nga Kaosi. Gjea është nëna e gjithësisë. Pyje, male, shpella të nëndheshme, dallgë deti, qiell i pamat, kanë ardhur të gjithë nga Gjea, Toka mëmë. Pra, së pari qe gremina, Gollja, gojë e stërmadhe në trajtë honi të zi, pa kufij, pastaj del në një dysheme të ngurtë, që është Toka, e cila kërcen lart, zbret teposhtë në thellësi.

Pas Kaosit dhe Tokës, së treti i vjen radha asaj çka grekët e quajnë *Eros*, që do ta emërtojnë më vonë “Dashuria e moçme”, (i paraqitur me flokë të bardhë): është Dashuria e kryehershme. Përse ky Eros i kryehershëm? Sepse, në ato kohëra të largëta, nuk kishte ende mashkull a femër, as qenie me

gjini. Ky Eros i kryehershëm nuk është ai që do të shfaqet më vonë, kur do të ketë burra dhe gra, meshkuj dhe femra. Qysh asohere, problemi do të jetë çiftëzimi i sekseve të kundërt, çka kërkon medoemos një dëshirë nga ana e secilit, njëfarë pëlqimi.

Pra, *Kaosi* është fjalë asnjane dhe jo mashkullore. *Gjea*, Toka mëmë, është pa dyshim femër. Mirëpo kë mund të dashurojë ajo përveç vetes, përderisa është fill e vetme me Kaosin? Erosi që shfaqet i treti, pas Golles dhe Tokës, nuk është, pra, si fillim, ai që udhëheq dashuritë gjinore. Erosi i parë shpreh një shpërthim në gjithësi. Ashtu siç doli Toka prej Golles, nga vetë Toka do të gëlojë gjëja që ajo mbart në thellësi. Ajo çka qe brenda saj e përzier me të, nxirret jashtë: ajo e pjell pa patur nevojë të bashkohet me ndokënd. Ajo çka Toka çliron e nxjerr në dritë është pikërisht çka kish qenë e struktur turbull brenda saj.

Toka pjell, së pari, një figurë mjaft të rëndësishme, *Uranin*, Qiellin, e madje Qiellin me yje. Mandej ajo sjell në jetë *Pontin*, domethënë ujin, të gjithë ujërat, e sidomos ato të detit. Pra, Toka i ngjiz, pa u bashkuar me ndokënd. Me anë të forcës së thellë që mbart në vete, Toka e zhvillon atë çka qe tashmë brenda saj, dhe që, duke nisur nga çasti kur e nxjerr jashtë, bëhet kopja dhe e kundërta e saj. Përse? Sepse ajo e krijon Qiellin me yje si të barabartë me veten, si kopje, po aq të qëndrueshme, po aq të fortë e me të njëjtin shtat me veten. Atëherë Urani shtrihet mbi të. Tokë e Qiell përbëjnë dy plane të gjithësisë, të vendosura njëri mbi tjetrin, një dyscheme dhe një kube, një shtrojë e një mbulojë që puqen plotësisht.

Kur Toka pjell Pontin, apo detin, ky e plotëson dhe futet me shkathtësi brenda saj, duke caktuar kufijtë me hapësirat e tij të mëdha ujore. Ashtu si Urani, Deti, përfaqëson po ashtu të kundërtën e Tokës. Nëse Toka është e fortë, e ngjeshur, dhe gjërat aty nuk mund të përzihen, Deti, nga ana e tij është, përkundrazi, vetëm lëngshmëri, rrjedhshmëri e paformë dhe e pakapshme: ujërat e tij përzihen, janë të padallueshme e rrjedhin së bashku. Në sipërfaqe, Ponti është i ndritshëm, por thellë brenda vetes ai është plotësisht i errët, çka e lidh atë, ashtu si Tokën, me një pjesë të Kaosit.

Kësisoj, bota ndërtohet duke u nisur nga tre qenësi të kryehershme: *Kaosi*, *Gjea*, *Erosi*, pastaj nga dy qenësi të lindura nga Toka: *Urani* dhe *Ponti*. Ato janë njëherësh fuqi natyrore dhe hyjni. *Gjea* është njëkohësisht toka, mbi të cilën ecim, dhe një hyjni. *Ponti* përfaqëson dallgët detare dhe përbën, gjithashtu, një fuqi hyjnore, së cilës i takon një kult. Aty zënë fill rrëfenja të një lloji tjetër, me ngjarje të dhunshme e dramatike...